

Sistema Socio Sanitario



Regione  
Lombardia

ATS Milano  
Città Metropolitana

# SEMUNDET TE PERCJELLA SEKSUALISHT, HIV/AIDS DHE PARAZITOZA



DIPARTIMENTO DI IGIENE E PREVENZIONE  
SANITARIA

MALATTIE A TRASMISSIONE SESSUALE / HIV

MTS Milano - viale Jenner 44  
Tel. 02 8578.9871

MTS Sesto San Giovanni - viale Matteotti 13  
Tel. 02 8578.2650

Email: [mtsmi@ats-milano.it](mailto:mtsmi@ats-milano.it)

# PERMBLEDHJA

Sëmundjet seksualisht të transmetueshme (SPS) janë të shkaktuara nga bakteret, viruset, kërpudhave ose parazitët që janë të transmetueshme nga personi në person nëpërmjet marrëdhënieve seksuale të pambrojtura (heteroseksuale ose homoseksuale).

Në trajtimin e sëmundjet të percjella seksualisht, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe për partnerët.

4  **CONDYLOMATOSIS**

5  **GONORREA**

6  **HEPATITI VIRAL**

7  **HERPESI GJENITAL**

8  **HIV/AIDS**

9  **KANDIDOZA dhe infeksione të tjera të aparatit gjeneral**

10  **KLAMIDIAS**

11  **SIFILIZI**

12  **MORRAT**

14  **QEROSA**

16  **ZGJEBA**

17  **AMBULATOR MTS**

18  **LINJA TELEFONIKE HIV/MTS**

19  **SHERBIMET HIV/AIDS**



# CONDYLOMATOSIS

## Cfare eshte?

Eshte nje infeksion qe shkaktohet nga nje virusi, Papillomavirus (HPV).

## Si shfaqet?

Infeksioni zhvillohet ne shumicen e rasteve pa sintoma ose shfaqet me mish te huaj (lythe apo kondiloma) te gjenitaleve. Ka raste qe kur infeksioni vazhdon per nje kohe te gjate, mbas disa vitesh mund te shkaktoje tumore te rrugeve gjenitale (ne miter, tek grate)

## Si percillet?

Gjate raporteve seksuale te pambrojtura. Perdorimi i prezervativit jo gjithmone te mbron nga ky infeksion qe mund te shfaqet edhe ne pjese te tjera te pa mbuluara nga preservativi.

## Diagnoza

Klinike me ane te vezhgimit te demtimeve ose tek grate me PAP testin.

Te gjitha grate, nga 25 deri ne 64 vjec duhet ta bejne çdo 3 vjet PAP testin per te parandaluar tumorin e qafes se mitres.

## Kura

Aplikim lokal i preparateve specifike, djegia e lytheve. Infeksioni mund te perseritet me shume se nje here.

## Parandalimi

Pervec prezervativit, ekziston nje vaksine per grate qe akoma nuk kane rene ne kontakt me virusin.



# GONORREA

## Cfare eshte?

Eshte nje infeksion bakterik, i shkakuar nga gonokoko qe gjendet ne sekrecionet e qelbezuara te organeve gjenitale tek personat e infektuar.

## Si shfaqet?

Mbas 2-20 ditesh nga momenti i ngjitjes, me djegie gjate urinimit ose jashteqitjes, me rrjedhje qelbi nga organet gjenitale (me e dukshme tek burrat), dhimbje fyti ne rast infeksioni te gojes. Ne se lihet pas dore mund te shkaktoje sterilitet tek grate.

## Si percillet?

Me raporte seksuale te pambrojtura, nepermjet kontaktit me pjesen e jashtme te gjenitaleve, vagjina, goja, anusi. Mungesa e kontaktit me spermen, nuk e eviton infektimin.

## Diagnoza

Me ane te nje tamponi te sekrecioneve gjenitale ose te gojes.

## Kura

Kurohet me antibiotike. Infeksioni mund te perseritet me shume se nje here.



# HEPATITI VIRAL

(Hepatitet A; B; C)

## Cfare jane?

Jane semundje virale qe prekin melçine.

## Si shfaqen?

- Hepatiti akut me verdhez (ngjyre e verdhe e lekures dhe e syve) dhe dhimbje melçie;
- hepatiti kronik: hepatiti B e ne veçanti hepatiti C, mund te perparojne me kalimin e viteve deri ne cirroze apo ne tumore te melçise;
- gjendja e “mbartesit te shendoshe” qe do te thote mungese e simptomave, por rrezik infektimi i personave te tjere.

## Si percillet?

- Raporte seksuale te pambrojtura (per hepatitin A: raporte oro-gjenitale).
- Kontakt me gjakun e personave te infektuar.
- Nga nena e infektuar tek femija (gjate shtatzanise ose lindjes).

## Diagnoza

Me ane te nje analize gjaku ku kerkohen antitruapat.

## Kura

Hepatiti A sherohet pa nderlikime, per hepatitin B dhe C te cilet mund te kthehen ne semundje kronike ekzistojne disa ilaçe me mjaft rezultat. Ekzistojne vaksinat per hepatitin A dhe B.



# HERPESI GJENITAL

## Cfare eshte?

Eshte nje infeksion i shkaktuar nga nje virus.

## Si shfaqet?

Mund te shkaktoje si probleme te lehta (skuqje apo djegie) si dhe flluska te panumerta / ulçerime qe japin dhimbje ne zonen gjenitale.

Infeksioni mund paraqitet perseri me kalimin e kohes, e sidomos ne raste stresi fizik apo psiqik, mbasi virusi vazhdon te qarkulloje neper organizem.

## Si percillet?

Me ane te raporteve seksuale te pambrojtura, ne kontakt me mukozat e infektuara.

## Diagnoza

Eshte klinike nepermjet vezhgimit te çarjeve.

## Kura

Nuk ekziston nje terapi qe e zgjidh problemin; ilaçet antivirale qe disponojme mund te ulin kohezgjatjen e çarjeve dhe intensitetin e simptomave, ashtu si edhe zvogelojne mundesine e perseritjes.



# HIV/AIDS

## Cfare eshte?

L'AIDS (sindroma e imunodeficenses se fituar) eshte nje semundje qe shkaktohet nga virusi HIV dhe konsiston ne uljen e mbrojtjesve te organizmit.

## Si shfaqet?

Mund te rrije per vite pa manifestuar asnje lloj shenji (Por edhe ne kete kushte mund t'i ngjitet partnerit) ose mund te manifestohet me sintoma qe kane shkalle te ndryshme rreziku.

## Si percillet?

- Nepermjet raporteve seksuale jo te mbrojtura (vagjinale, anale, orogjenitale) me personat e infektuar.
- Gjaku: shkembim i shiringave te infektuara, instrumentave per tatuazhe e piercing te infektuara me gjakun e dikujt tjeter, perdorimi i perbashket i disa objekteve siç mund te jene (brisqet, gersheret, furçat e dhembeve, etj) te kontaminuara.
- Nga nena e infektuar tek femija (gjate shtatzanise, linde apo dhenies se gjiut).

## Si nuk percillet:

- nepermjet shtrengimit te duarve, puthjeve, perqafimeve, kafshimeve, gervishtjeve;
- peshtymes, kollitjes, loteve, djerses, urines, jashteqitjes;
- pjatave, gotave, lugeve, pirunjve e thikave
- banjove, dushave, pishinave, saunave, palestrave.

## Diagnoza

Testi për zbulimin e antitropave të HIV mund të bëhet pas tre muajsh që nga sjellja e rrezikut fundit.

## Kura

Terapia me ilaçe antivirale eshte aktualisht mjaft efikase ne mbajtjen nen kontroll te infeksionit e duhet te vazhdohet gjate gjithë jetes.



# KANDIDOZA

## dhe infeksione te tjera te aparatit gjenital

## Cfare eshte?

*Candida*, *Trichomonas*, *Micoplasma* mund te shkaktojne infeksione te aparatit gjenital e te rrugeve urinare, me shume tek grate, por edhe tek burrat.

Kandidoza shkaktohet nga nje kerpudhe qe jeton ne trupin tone pa na shkaktoje probleme dhe qe manifestohet ne raste te mungeses se higjenes, te imuno-depresionit (patologjite kronike, terapite me antibiotik, diabeti). Pra, kjo lloj semundjeje nuk eshte e lidhur patjeter me aktivitetin seksual, por mund te percillet prej tij.

## Si shfaqet?

Me sekrecione te rrugeve gjenitale qe kane pamje karakteristike ne baze te tipit te infeksionit, te kruara dhe skuqje ne hapësiren gjenitale apo anale, dhimbje gjate urinimit dhe raportit seksual.

## Si percillet?

Me raporte seksuale jo te mbrojtura.

## Diagnoza

Duke ekzaminuar ne mikroskop sekrecionet gjenitale si dhe me analizat qe konsistojne ne mbjedhjen e kerpudhes.

## Kura

Antibiotike/antimykotike qe merren prej goje ose me terapi lokale (Ovule, kremere, solucione intime lares).



## KLAMYDIA

### Cfare eshte?

Eshte nje infeksion i shkakuar nga baktere qe jetojne ne brendesi te celulave.

### Si shfaqet?

Shpesh nuk ka sintoma, por pas 1-3 javesh mund te shkaktoje infeksione te rrugeve gjenitale.

Tek burrat dhe tek grate jep: djegie gjate urinimit, sekrecione te penisit, dhimbje barku, pasoja ne miter qe mund te çojne deri ne sterilitet (infeksion kronik).

Gjate shtatzanise mund te shkaktojne abort spontan.

### Si percillet?

Me raporte seksuale jo te mbrojtura.

### Diagnoza

Me nje tampon te veçante te sekrecioneve gjenitale ose me nje kampion te urines.

### Kura

Me antibiotike.



## SIFILIZI

### Cfare eshte?

Shkaktohet nga nje bakter(spiroketa) qe quhet *Treponema Pallidum*.

### Si shfaqet?

Periudha e inkubacionit ndryshon nga 10 deri ne 90 dite (mestarja 21 dite) pas se ciles mund te kemi kuadre klinike te ndryshme: ulçerizim i vogel pa dhimbje, ne piken ku ka ndodhur infektimi (gjenitalet apo goja), qe nuk zgjat shume.

### Si percillet?

Nepermjet kontaktit direkt me plaget i infektuara (seks vagjinal, anal dhe gojor).

Mund te percillet nga nena tek fetusin, gjate shtatzanise, duke shkakuar vdekjen e fetusit ne miter ose lindjen e nje femije te infektuar nga sifilizi.

### Diagnoza

Me nje analize te gjakut per kerkimin e antitropave, mesatarisht 40 dite pas infektimit. Duhet te kontrollohen edhe partneret me te cilet eshte bere seks.

### Kura

Kurohet me antibiotike.



# MORRAT

(e kokes dhe e pubes)



## Cfare eshte?

Eshte nje parazitologji e shkaktuar nga morrat, te cilet depozitohen vezet (*therijat*) qe hapen ne 7-10 dite. Larvat e perfundojne zhvillimin e tyre ne harkun e 7-13 diteve.

Vezet ngjiten ne rrenjen e flokeve me nje substance ngjitese shume rezistente qe kreheri nuk arrin t'i shkepute.

## Si shfaqet?

Sintoma me karakteristike, por qe nuk shfaqet gjithmone eshte e kruara a lokalizuar e lekures se kokes ose e organeve gjenitale.

## Si percillet?

Parazitologjia perhapet kryesisht ne kushte te grupimeve te medha (shkolla, oratore, shtepi pushimi, etj), permes kontaktit direkt me personin e infektuar (edhe gjate aktit seksual) ose indirekt me ane te kreherave, furçave te flokeve apo vete flokeve. Infektimi nuk ka te beje me nivelin e pastertise te seicilit prej nesh.

## Diagnoza

Me ane te vezhgimit me nje lente te morrit ose te vezeve ne floke, ne qimet e organeve gjenitale dhe ne disa raste edhe ne vetulla, qerprike apo ne mjeker.

## Kura

Ekzistojne produkte si kremera, shkuma apo gjel. Ne shumicen e rasteve, vezet dhe morrat duhet te pastrohen edhe me ane te nje kreheri.

Per vezet mund te perdoret edhe nje perzierje e nxehte me gjysem sasie uje dhe me gjysmen tjetert uthull.

Pas nje jave per te mbytur morrat e lindur nga veze jo te mbytura duhet qe trajtimi te perseritet.

Nuk ka trajtime parandaluese: ilaçi anti parazit nuk parandalon infektimin, pra nuk mund te perdoret me qellim parandalues.

## Masat perfundimtare qe duhet te merren

Kontrolli i te gjitha pjesetarve te familjes si dhe i personave te tjere qe kane patur kontakt me te infektuarin.

Larja ne lavatriçe (60°) ose ne lavanderi me te thate e kellefave te jastekeve, çarçafeve, peshqireve dhe e veshjeve (ne veçanti kapela, shalla, lojra prej stofe, etj) te cilat jane ne kontakt me koken dhe qafen; kalimi i fsheses me korrent mbi poltrona, divana, dysheke e qilima ku lozin femijet.

Kreherat dhe furçat e flokeve zhyten per 10 minuta ne uje te valuar.

Dizinfektimi i hapësirave nuk ka ndonje te mire, mbasi morri nuk jeton ne ambiente per nje kohe te gjate.

Per te evituar infektimin porositen familjet per nje kontroll te shpeshte, te pakten javor te flokeve.

# QEROSA

(e kokes dhe e trupit)

## Cfare eshte?

Qerosa eshte nje semundje ngjitese e lekures, e qimeve dhe e thonjve qe shkaktohet nga kerpurdha te ndryshme te njohura me emrin *dermatofite*.

## Si shfaqet?

Periudha e inkubacionit eshte e ndryshme dhe shkon nga 5 deri ne 14 dite nga momenti i kontaktit.

Semundja shfaqet me njolla te rrumbullaketa e te skuqura qe kane si tendence perhapjen nga periferia dhe skjarimin drejt qendres.

Ne rastin e qeroses se kokes , floket keputen me lehtesi. Mbas fillimit te trajtimit te duhur, semundja nuk eshte me ngjitese.

## Si percillet?

Infeksioni percillet me ane te kontaktit te drejtperdrejte me kafshe te infektuara (qeni, macja) ose me persona te semure.

Mund te percillet edhe me ane te kontaktit te terhorte dhe ne veçanti nga perdorimi i perbashket i veshjeve, kreherave, furçave te flokeve, kapelave dhe kepuceve.

## Diagnoza

E ben specialisti nepermjet vizites klinike dhe analizave mikroskopike.

## Kura

Me ilaçe per perdorim te lokalizuar si dhe me ilaçe qe merren per goje.

## Si mund te parandalohet?

Duke vene ne jete rregullat e higjenes te cilat duhet te respektohen nga te gjithë, siç jane:

- perdorimi krejt personal i veshjeve, kapelave, furçave, kreherave dhe sendeve te tualetit ne pergiithesi;
- evitimi i te ecurit me kembe zbadhur ne vende publike si pishina, palestra, dusha, etj;
- dizinfektimi me kujdes i kembeve perpara se te hyhet ne pishine;
- evitimi i ledhatimit te qenve, maceve ose kafsheve te tjera te cilave nuk i njihet gjendja shendetesore e aq me teper ne qofte se verejme qe e kane qimen e semure;
- i duhen bere kontrolle te rregullta tek veterinari kafsheve qe mbahen ne shtepi.

## Cfare duhet bere per te mos e perhapur semundjen?

Eshte e rendesishme te zbatohen rregullat e meposhtme:

- larja me vehte e te brendeshmeve ne lavatrice me 90°;
- kontrolli tek veterinari i kafsheve qe mund te kene qene ne kontakt me personat e semure (kafshet mund te jene mbartes te shendetshem).



## Cfare eshte?

Eshte nje semundje e lekures e shkaktuar nga nje insekt shume i vogel, i padukshem me sy e qe quhet kepushe. Kepushat i ngjiten veshjeve qe jane ne kontakt me lekuren e semure e ne kete menyre perhapen.

## Si shfaqet?

Semundja shfaqet me te kruara te bezdisshme e kryesisht gjate nates.

## Si percillet?

Paraziti i percillet njerezve nepermjet:

- kontaktit direkt me personat e semure;
- kontaktit indirekt, me ane te perdorimit te perbashket te nderresave, peshqireve apo te te brendeshmeve etj, te cilat jane perdorur pak.

## Diagnoza

Me ane te vezhgimit te kepushes qe gjendet ne lekure.

## Kura

Me ilace qe aplikohen ne menyre lokale ne gjithë lemure.

Qendrat **MTS Milano**

Viale Jenner, 44

**Tel. 02/8578.9871**

nga e **HENA** deri te **PREMTEN**  
**8:15 – 15:30**

Qendrat **MTS Sesto San Giovanni**

Viale Matteotti, 13

**Tel. 02/8578.2650**

**HENA** dhe të **ENJTEN**  
**8:15 – 15:30**

Email: [mtsmi@ats-milano.it](mailto:mtsmi@ats-milano.it)

## Sherbimet (falas):

- bashkebisedit informativ me karakter mjekesor;
- test i HIV dhe analiza sierologjike e me instrumenta per infeksione te tjera te percjella seksualisht (sifilizi, hepatiti, uretriti, kondilomi, clamidi);
- vizita dermatologjike, gjinekologjike dhe te semundjeve ngjitese;
- trajtim me ilace i semundjeve veneriane;
- orientim mbi sherbimet qe kane te bejne me ndihmen psicosociale.

Nuk kerkohen dokumenta identifikimi, receta e mjekut, tesera shendetsore. Mund te paraqitesh personalisht, por eshte me mire te prenotohet qe me pare takimi, sepse disa sherbime mund te kryhen vetem ne disa orare te caktuara. Sherbimet i ofrohen edhe personave qe nuk jane ne moshe madhore (duke patur parasysh rregullat e dhenies se konsensusit) si dhe subjekteve te huaj ose qe nuk jane banues te zones.



## LINJA TELEFONIKE HIV/MTS

Tel. 02/8578.8912

Aktivitetet:  
nga e HENA deri te ENJTEN  
9:30 – 15:30

### Oferta:

- Orientim mbi kryrjen e testit të HIV, të analizave diagnostikuese e të vizitave të specializuara për SPS;
- informacion me karakter shëndetësor mbi infeksionet e përcjella seksualisht;
- konsulence mbi aspektet psikologjike, shoqërore, kulturore të seksualitetit;
- degjim e mbështetje psikologjike e nivelit të parë për situatat problematike (diagnoze e HIV ose e SPS, home e biseksualitet, shqetësime psikoseksuale, patofobie).

### Kujt i drejtohet:

- Personave që janë me të ekspozuara kundër infektimit për vetë stilin e jetës që ato bëjnë ose të faktorëve favorizues (Raporte me pagesë, homo e biseksualitet mashkullor, turizmi seksual);
- adoleshente, të rinjë dhe të rritur që hasin vështirësi në sferën e marrëdhënieve fizike intime apo të relacionale;
- subjekte të cilëve u janë diagnostikuar HIV apo SPS, partneret e tyre apo të afermit.
- Individë të preokupuar për shëndetin e tyre apo për pasojat e aktit seksual.



## SHERBIMET HIV/AIDS

Viale Jenner, 44  
Tel. 02.8578.9031/9032  
Fax 02.8578.9884

Email: [mtsmi@ats-milano.it](mailto:mtsmi@ats-milano.it)

Sekretaria:  
nga e HENA deri te PREMTEN  
8:30 – 15:30

Kerkesat mund të paraqiten nga qytetarë të veçantë ose nëpërmjet operatorëve të strukturave publike dhe shoqatave.

### Sherbimet:

- pritje dhe analizim i nevojave;
- mbështetje dhe orientim i pacientit dhe i familjes së tij në përdorimin e shërbimeve socialo-mjekësore të territorit;
- asistencë në shtëpi nëpërmjet ndërhyrjeve infermieristike, rehabilituese e mbrojtëse;
- edukim shëndetësor mbi masat higjienike e parandalimin;
- dërgimi në strukturë të akredituara për të semuret me Aids (Qendra ditore, Shtëpi-banimi, ospice).

Sistema Socio Sanitario



Regione  
Lombardia

ATS Milano  
Città Metropolitana



**ATS Città Metropolitana di Milano**

C.so Italia 19 – 20122 Milano

[www.ats-milano.it](http://www.ats-milano.it)



**MTS**

Centro di Riferimento HIV e Malattie a Trasmissione Sexuale